LIGJ
Nr. 123/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 107/2015, "PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SHËRBIMET E BESUARA"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2015, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 7, në fund të pikës 1, hiqet termi "elektronik".

Neni 2

Në nenin 27, paragrafi i fundit zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:
"Rregullat për ofrimin e shërbimeve publike elektronike, që përfitohen nëpërmjet transmetimit elektronik, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Në nenin 34, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:
"Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 15.12.2016

Shpallur me dekretin nr. 9929, datë 30.12.2016 të Presidentit të Republikë së Shqipërisë, Bujar Nishani

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 910/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon Direktivën 1999/93/KE", Numri CELEX 32014R0910, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.257, datë 28.8.2014, faqe 73-114.*